

Analiza e kuadrit ligjor, politikave dhe strategjive për zhvillimin e hidrocentraleve në Shqipëri dhe rekomandime për përmirësimin e tyre

I. HYRJE

Nga vëzhgimi dhe studimi i zbatimit në praktikë të kornizës komplekse ligjore që rregullon procedurat koncesionare në sektorin hidroenergjetik, rezulton se në rrënjë të shumicës së problemeve gjatë këtyre procedurave nga autoritetet publike janë edhe një sërë boshllëqesh dhe konfliktesh në kuadrin ligjor në fuqi që rregullon në tërësi procedurat për koncesionet hidro-energjetike.

Ligjet që ndërveprojnë në fushën e koncesioneve hidro-energjetike janë të shumta, të miratuara në kohë të ndryshme, të pa harmonizuara me njëra tjetrën dhe të komplikuar për tu zbatuar në mënyrë të harmonizuar.

Nga ana tjetër, Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga 2014 dhe palë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (2006) është e detyruar të zbatojë legjislacionin komunitar dhe angazhimet e marra ndaj traktatit.

Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mbrojtjes së mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjëse.

Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin dispozita që trajtojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuar gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e acquis.

Angazhimet kryesore sipas fushave të legjislacionit janë si vijon:

A. Në fushën e procedurave koncesionare, angazhimet janë të lidhura me përafrimin e legjislacionit vendas me Direktivën për Koncesionet.

B. Në fushën e mjedisit të lidhur me energjinë, angazhimet e qeverisë janë përafrimi dhe zbatimi i plotë i Direktivave të lidhura me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

C. Në fushën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, angazhimet janë të lidhura me përafrimin e legjislacionit vendas me paketën e legjislacionit horizontal të BE-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të cilat janë shprehur përmes ligjeve përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM).

D. Në fushën e përdorimit të burimeve ujore, qeveria është angazhuar për përafrimin e plotë të legjislacionit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore me Direktivën Kuadr të Ujit.

E. Në fushën e energjisë për sa e lidhur me hidro-energjinë, qeveria është zotuar në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë duke realizuar edhe përafrimin e legjislacionit vendas me atë komunitar për energjitë e rinovueshme.

Ndërtimi dhe operimi i hidrocentraleve (HEC) në Shqipëri realizohet përmes procedurave koncesionare për HEC-et me fuqi të instaluar mbi 2 MW, ndërsa për HEC-et e vogla me fuqi nën 2 MW, nëpërmejt procedurave të vecanta konkurruese të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Autoritetet kryesore përgjegjës për koncesionet e hidrocentraleve të vegjël në Shqipëri janë:

Këshilli i Ministrave;

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)

Agjencia Kombëtare për Burimet Natyrore (AKBN)

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)

Ministria e Mjedisit (MM)

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Agjensitë Rajonale të Mjedisit (ARM)

Këshilli Kombëtar i Ujit/Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Ujore)

Këshillat e Baseneve Ujore dhe Agjencive të Baseneve Ujore

Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë)

Palët e përfshira janë zhvilluesit dhe investitorët privatë, institucionet financiare ndërkombëtare dhe kombëtare, publiku dhe OJF të interesuara.

II. KUADRI LIGJOR EKZISTUES

Per efekt të shqyrtimit të akteve të ndryshme ligjore e nënligjore që normojnë dhe rregullojnë direkt apo indirekt procedurat për koncesionet hidro-energjetike i kemi grupuar ato në 5 (pesë) fusha të legjislacionit që ndikon dhe duhet mbajtur në konsideratë në realizimin e këtyre procedurave si vijon:

A. Procedurat koncesionare

B. Mjedisi dhe mbrojtja e natyrës

C. Informimi dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

D. Burimet ujore

E. Energjia e rinovueshme

Në të njëjtën mënyrë, për efekt të analizës së përputhshmërisë së këtyre akteve është bërë edhe grupimi i legjislacionit respektiv të BE-së.

II.1 - KORNIZA LIGJORE VENDASE

II.1.A - KONCESIONET

- 1 Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, ndryshuar me Ligjin Nr.88/2014 dhe Ligjin Nr.77/2015.
 - 1.1 VKM nr. 575 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ppp” datë 10.07.2013, ndryshuar me VKM nr. 313 date 27.04.2016 dhe me VKM Nr. 146, datë 22.2.2017;
 - 1.2 VKM nr. 576, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet”;
 - 1.3 VKM nr. 130, datë 12.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat”;
 - 1.4 VKM nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, ndryshuar me VKM Nr. 718, datë 12.10.2016.

II.1.B - MJEDISI DHE MBROJTJA E NATYRËS

- 1 Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- 2 Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
 - 1.1 VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- 3 Ligji nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4 Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 69/2014.
- 5 Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”.
 - 5.1 VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin evropian”.

II.1.C - INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

- 1 Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)”.
 - 1.1 VKM nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;

- 1.2 VKM nr. 620, datë 07.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar”.
- 2 Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)”, të ndryshuar Ligji nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
 - 2.1 VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
 - 2.2 VKM nr. 598, datë 01.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”;
 - 2.3 VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”;
- 3 Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
 - 3.1 VKM nr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e publikut në vendimmarrje për mjedisin”;
 - 3.2 VKM nr.16, datë 04.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”;
 - 3.3 VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
 - 3.4 Urdhëri i Ministrit nr. 1, datë 03.03.2009 “Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- 4 Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

II.1.D - BURIMET UJORE

- 1 Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”;
 - 1.1 VKM nr. 177, datë 26.03.2014 “Për krijimin, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të posaçëm të administrimit të ujërave ndërkufitarë”, i ndryshuar;
 - 1.2 VKM nr. 246, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë”;

1.3 VKM nr. 267, datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”;

1.4 VKM nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”;

1.5 VKM nr. 342, datë 4.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorial dhe hidrografik të baseneve ujore në RSH dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”

II.1.E - ENERGJIA E RINOVUESHME

1 Ligji 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”.

II.2 - KËRKESAT E MSA DHE LEGJISLACIONIT TË BE

II.2.A - KONCESIONET

- 1 Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- 2 Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- 3 Direktiva 2014/25/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin nga entet që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.

II.2.B - MJEDISI DHE MBROJTJA E NATYRËS

- 1 Direktiva 2009/147/EC e datës 30 Nëntor 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër” (versioni i konsoliduar);
- 2 Direktiva 92/43/EEC e datës 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër”, e ndryshuar nga Direktivat 97/62/EC dhe 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003;
- 3 Direktiva 2004/35/ EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21.04.2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi mjedisin”, amenduar me Direktivën 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15.03.2006;
- 4 Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27.06.2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”(VSM);

- 5 Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13.12.2011 “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private”, amenduar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.04.2014 (VNM).

II.2.C - INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIM MARRJE

- 1 Direktiva 2003/98/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 nëntor 2003 për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, amenduar me Direktivën 2013/37/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, e cila ndryshon Direktivën 2003/98/KE “Për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;
- 2 Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26.05.2003 mbi “Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve e programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi të Direktivave të Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC”;
- 3 Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, datë 28.01.2003 mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/EEC;
- 4 Vendimi i Këshillit të BE-së 2005/370/EC, datë 17.02.2005 për miratimin në emër të Komunitetit Evropian të Konventës për të drejtën për informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatave për çështjet mjedisore.

II.2.D - BURIMET UJORE

- 1 Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave të ujit, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EC dhe 2014/101/EU

II.2.E - ENERGJIA E RINOVUESHME

- 1 Direktiva 2005/89/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 janar 2005 mbi masat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe të investimeve në infrastrukturë;
- 2 Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
- 3 Direktiva 2012/27/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi eficientësinë e energjisë, që amendon Direktivën 2009/125/KE dhe 2010/30/BE, që shfuqizon Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE.

II.3 MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

- 1 Konventa për Biodiversitetin, ratifikuar pjesërisht në 1994; pjesë të protokollit ratifikuar në 2005;

- 2 Konventa e Bernës “Për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habiteteve Natyrore në Evropë” (1976), ratifikuar më 13/01/1999;
- 3 Konventa e Aarhusit, “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore” (1998), ratifikuar më 27/06/2001;
- 4 Konventa e Bonnit “Për ruajtjen e specieve migratore dhe kafshëve të egra” (1979), ratifikuar më 01/09/2001;
- 5 Konventa Espoo “Për VNM-në në kontekstin ndërkuftar” së bashku me amendimet e protokollit (1991), ratifikuar më 12/05/2006.

II.4 STRATEGJITË, PLANET, PROGRAMET

I. PROCESI I ADERIMIT NË BE

Me firmosjen e MSA-së, Shqipëria është angazhuar për të pranuar, tranzpozuar dhe zbatuar gjithë legjislacionin e BE-së. Ky detyrim i lind Shqipërisë nga fakti i legjislacionit të MSA dhe konventave përkatëse¹. Një veprim tjetër detyruar për Shqipërinë lind nga statusi i saj si Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ku palët kontraktuese të traktatit kanë detyrime të qarta dhe afate për të adoptuar dhe zbatuar legjislacionin e lidhur me sektorin e **energjisë/tregun** dhe zhvillimin e tij dhe njëkohësisht **mjedisin**. Për efekt të analizës së këtij studimi disa nga pjesët e legjislacionit ku Shqipëria është e detyruar lidhur me faktin e të qenit palë janë:

- Direktiva për eficientësinë e energjisë,
- Direktiva për energjitë e rinovueshme,
- Legjislacioni mjedisor i përfshirë në Traktatin e Energjisë është direktiva e VNM 2011/92/EU e ndryshuar me 2014/52/EU; Direktiva e VSM 2001/42/EC; Direktiva e Zogjve 79/409/EEC; Direktiva për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe rehabilitimin e dëmit mjedisor 2004/35/EC e ndryshuar me Direktivën 2006/21/EC, 2009/31/EC, 2013/30/EU;

a) Strategjia Rajonale e Energjisë 2020 – Traktati i Komunitetit të Energjisë

Në tetor 2012, këshilli ministror miratoi strategjinë rajonale të energjisë. Strategjia Rajonale e Energjisë është zhvilluar me tre skenarë: gjendja ekzistuese, një skenar i dytë “investime me kosto minimale” i cili vlerëson se çfarë kërkohet për tu bërë minimumi që të

¹ Direktiva për energjitë e rinovueshme (Direktiva 2009/28/EC); Direktiva për Eficencën e Energjisë (2012/27/EU; 2010/30/EU;2010/31/EU); Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (Direktiva 2011/92/EU e amenduar me Direktivën 2014/52/EU; Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Direktiva 2001/42/EC); Direktiva Kuadër e Ujit 9Direktiva 2000/60/EC); Direktiva e habitateve (Direktiva 92/43/EEC); Direktiva e Zogjve (Direktiva 2009/147/EC); Direktiva e përmbajtjeve (Direktiva 2007/60/EC); Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike (Shqipëria ka ratifikuar konventën dhe ka përcaktuar kontributin e vet lidhur me Objektiven e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.13 për Ndryshimet Klimatike); Konventa e Aarhusit; Konventa e Espoo-s (Konventa e UNECE për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekst Ndërkuftar); Konventa e Bernës (për mbrojtjen e botës së egër habitateve natyrore në Evropë).

arrihet kërkesa për energji e konsumatorëve, dhe e fundit, vlerësohet edhe një skenar me qëndrueshmëri/ emetime të ulta i cili prezumon që rajoni avancon në një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm. Për çdo skenar është analizuar dhe kosto e investimit për 2020, 2025 dhe 2030. Gjithashtu janë parashikuar edhe objektivat konkrete e veprimet dhe sfidat janë zbatimi i tyre plotësisht. Por dy nga objektivat kryesore të ndërmarra nga vendi ynë në kuadër të detyrimeve të saj si palë kontraktuese e komunitetit të energjisë janë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i masave për rritjen e përdorimit eficient të energjisë duke arritur një objektiv minimal kursimi prej 9% deri në 2018;
- Vendosja e masave dhe veprimeve për arritjen e objektivit kombëtar për ndarjen e burimeve të rinovueshme të energjisë me 38% deri 2020 nga energjitë e rinovueshme.

Krijimi i një tregu energjetik të EJL do të ofronte furnizim të besueshëm dhe të përballueshëm financiarisht.

b) Strategjia e Evropës Juglindore 2020 – Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal


Ndërsa në kuadrin mjedisor, detyrimi kryesor që rrjedh prej traktatit të energjisë ka të bëjë me respektimin e direktivave për VNM/VSM, direktivën e habitateve dhe shpendëve gjatë hartimit, zhvillimit të projekteve energjetike. Megjithatë, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) avancon më tej në asistencën ndaj vendeve të rajonit dhe dokumenti kyç është strategjia SEE 2020 “Për punësim dhe prosperitet në një perspektive Evropiane”.² Në fushën e mjedisit, paraqet se sfida është zbatimi i direktivës evropiane të ujit lidhur me ujin dhe qeverisjen mjedisore në nivel kombëtar duke përmendur si më poshtë: vështirësitë në përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve, mungesa e koordinimit ndërmjet aktorëve me kompetenca mbi burimet ujore, kosto e infrastrukturës për zbatimin e masave; mungesa e kapaciteteve të dizenjimit, zbatimit dhe monitorimit; fakti që basenet shtrihen përtej kufijve duke paraqitur nevojën për bashkëpunim ndërmjet vendeve për menaxhimin e burimeve. Në fushën e ujit prezantohet nisma për Marrëveshjen Kuadër për Menaxhimin e Integruar Rajonal të Ujërave (RIWMFA) ku do shikohet neksus-i ndërmjet ujit, energjisë, mjedisit dhe sektorit të bujqësisë i cili do fillojë zbatimin e vet në 2020.

c. Një Strategji rajonale për hidro-energji të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor

Me qëllim balancimin e rolit të energjisë hidrike në zgjedhjen e alternativave të energjisë në rajon, ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese me karbon të ulët dhe përdorimin e burimeve vendase me qëllim uljen e varësisë së energjisë nga jashtë dhe me nevojën për të ndërtuar hidroenergjinë në një mënyrë më të qëndrueshme sesa në të kaluarën, Bashkimi Evropian ka mbështetur një *Strategji Rajonale për Hidroenergji të Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor*. Studimi u kërkuar në samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris 2016 dhe ka përfunduar në fund të 2017. Strategjia i mëshon faktit se hidroenergjia është vetëm një nga elementët mes asaj të erës, diellit, biomasës, etj; fokusi duhet të jetë si fillim në rehabilitimin e projekteve ekzistuese, vetëm një numër i limituar projektesh duhet të ndërtohen për shkak të ndikimit të lartë në mjedis, ndryshimet klimaterike etj. Në Shqipëri prioritetet i jepej rehabilitimit të hidrocentralit të Vaut të Dejës, Shkopetit dhe Ulzës dhe

² <file:///D:/Downloads/South%20East%20Europe%202020%20Strategy.pdf>

ndërtimit të hidrocentraleve të reja si ai i Skavicës dhe Katundit. Nga projektet e marra në konsideratë, strategjia rekomandon që Shqipëria ka vetëm **9.6%** potencial shtesë për të ndërtuar kapacitete të reja.



II. DOKUMENTET STRATEGJIKE KOMBËTARE

1. Strategjia Kombëtare e Sigurisë 2014

Është miratuar me ligjin 103/2014 për “Miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Në themel të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë është aspirata e popullit shqiptar dhe vullneti politik për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqenie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm. SSK ka 9 objektiva strategjike dhe një sërë objektivash plotësues. Objektiv 3 për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nxit **“përdorim të kursyer të burimeve natyrore për brezat e ardhshëm”** dhe një ndërthurje mes sektorëve të energjisë, mjedisit, turizmit dhe bujqësisë. Por mbi të gjitha SSK i mëshon idesë së diversifikimit të burimeve, energjisë me qëllim garantimin e sigurisë së kombit dhe mirëqenies. SSK klasifikon rreziqet që i kanosen vendit duke i kategorizuar në dy nivele: rrezik i nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Siguria energjetike është rrezik i nivelit të parë dhe njëkohësisht degradimi mjedisor, shkatërrimi i mjedisit dhe shpyllëzimi përbën rrezik të nivelit të parë. Por, ndërsa përgjigja ndaj rrezikut të sigurisë energjetike është diversifikimi, në rastin e mjedisit nuk ka diversifikim veçse përmirësim dhe rehabilitim. SSK përcakton dhe detyrat përkatëse të çdo institucioni dhe i takon qeverisë të gjejë balancën e zhvillimit ekonomik për sektorët përkatës. Megjithatë nuk ka një analizë tërësore nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare (përgjegjës për sigurinë kombëtare) për të analizuar kërcënimin që vjen nga degradimi mjedisor dhe ku është Shqipëria sot, duke qenë se kemi një përplasje/konkurrencë mes sektorëve strategjikë.

2. Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030

Plani i Përgjithshëm Kombëtar ndryshe (Shqipëria 2030) është dokumenti më i lartë planifikues kombëtar dhe referues për gjithë planet, strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale. Ai përcakton orientimet kryesore të zhvillimit të turizmit bazuar në potencialet e territorit. Harta e potencialit turistik brenda këtij plani ilustron zona të cilat klasifikohen si Zona me Rëndësi Kombëtare për vlerat që kanë në planikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Një numër i konsiderueshëm i këtyre zonave rregullohet nga legjislacioni sektorial në fuqi, si p.sh: zonat e mbrojtura natyrore; burimet ujore dhe fashat e tyre mbrojtëse; zonat minerare; zonat industriale; zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore; monumentet e kulturës; zonat dhe parqet arkeologjike; qendrat historike; brezi bregdetar, etj. PPK-ja mbështet dhe fuqizon rëndësinë që kanë këto zona për interesin kombëtar duke zgjeruar territoret e shpallura në mbrojtje të një pjese të tyre, por edhe duke propozuar zona të reja, të cilat duhet të merren në mbrojtje në përputhje me procedura të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi. Në hartën e potencialit turistik detajohet lista e zonave me rëndësi kombëtare, të cilat kanë rëndësi specike për potencialin turistik të vendit. Ndërsa në pjesën e objektivave natyrore PPK parashikon dhe korridoret natyrore dhe mjedisore dhe shtimin e zonave të gjelbërta në linjë me strategjinë ndërsektoriale mjedisore dhe atë të zonave të mbrojtura duke shtuar parkun e madh të Alpeve, parkun e Bunës dhe atë të Vjosës përgjatë lumenjve. Objektivat janë shtimi me 20% i zonave të mbrojtura tokësore dhe 15% të zonave detare deri në 2030. Në këtë linjë

shikohet që luginat e lumenjve të kthehen në pjesë të atraksioneve turistike, biodiversitetit dhe të zhvillohet njëkohësisht me planet e menaxhimit për sinkronizim sa më të mirë.

2. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) II, 2015-2020

SKZHI II është dokumenti bazë dhe themelor i qeverisë i cili përkthen objektivat dhe programet e qeverisë në një udhërrëfyes konkret, dhe krijon sinergji mes gjithë strategjive ndër sektoriale, sektoriale dhe objektivave strategjike.³ Strategjia është e bazuar në SPS (Sistemin e Planifikimit Strategjik) i cili kombinon politikën, planifikimin dhe buxhetimin në tre komponentë kryesorë:

strategjitë kombëtare dhe sektoriale duke paraqitur orientim për politikë-bërjen e nivelit të lartë; procesin e integritit evropian që përshkruan planifikimin dhe kërkesat për burime për arritjen e objektivave të vendosur sipas axhendës Evropiane; procesin e buxhetit afat-mesëm ku detajohet planifikimi afat shkurtër dhe afatmesëm dhe financimi për zbatimin e politikave nga secila agjenci dhe ministri.

Vizioni i SKZHI II është i ndarë në 3 komponentë kryesorë:

- Një Shqipëri gati për tu bërë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian;
- Rritje e fortë dhe e qëndrueshme ekonomike për Shqipërinë;
- Shndërrimi i rritjes dhe pasurisë në përmirësim të mirëqenies për qytetarët përmes një shoqërie kohezive dhe të drejtë.

Në këtë kontekst, do të bëjmë një analizë strategjike për të parë sesi gërshetohen vizionet e paraqitura në SKZHI II me objektivat strategjike sektoriale si energjia, uji, mjedisi, turizmi të cilat përbëjnë dhe interesin e këtij studimi. Vizioni i SKZHI II për sektorin energjetik është *“Një sistem energjetik i bazuar në parimet e tregut, që është në gjendje të plotësojë kërkesën për energji, për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, që garanton mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me kosto minimale sociale”*. Si objektivi strategjik për nën-sektorin e energjive të rinovueshme dhe efikasitetin energjetik deri në 2020 janë: plotësimi i angazhimeve të Shqipërisë në kuadrin e iniciativës 20/20/20, me qëllim rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme; (2) përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe ulja e emetimeve të karbonit (CO₂); (3) Diversifikimi i burimeve të rinovueshme në vend, **jo vetëm nga burimet hidrike, por dhe nga era, dielli, biomasa dhe burimet gjeotermike**; dhe (4) menaxhimi i kërkesës për energji përmes rritjes së efikasitetit të përdorimit të energjisë, sidomos në strehim.⁴

Pra dokumenti strategjik e ka parashikuar qartësisht se energjitë e rinovueshme do të jenë jo vetëm nga burimet hidrike por kërkohet diversifikim i energjisë. Për këtë arsye është përgatitur dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme.

2.1. Strategjia Kombëtare e Sektorit Energjetik për periudhën 2015-2030

³ miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016

⁴ Këtu ka parasysh mirëmenxhimi i energjisë në ndërtesa.

Më prill 2012 u hartua draft Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020 duke ndjekur vijimin e strategjive të mëparshme 2007-2013. Megjithatë draft strategjia nuk avancoi më dhe ka mbetur si dokument i brendshëm brenda ministrisë së energjisë dhe institucioneve të varësisë së saj. Vlen të përmendim, se në periudhën 2007-2011, nga analiza në mënyrë të detajuar e të dhënave të prodhimit të energjisë elektrike, vërehen ndryshime jashtëzakonisht të mëdha. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e **lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike** në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, **të mbështetur vetëm në HEC-e**. Duke u fokusuar të humbjet në 2011 ato ishin 35.5% ose e shprehur në shifra 2,613 milion kWh.

1 kWh = 9.5 All x 2,613 milion kWh = 248 Milion EUR (afërsisht⁵)

Pra vlera e humbjeve (teknike + vjedhjeve/mos pagesave) ishte e tillë sa nuk lë vend për shumë diskutim se nga duhet të vijë zgjidhja e sektorit.

Në këtë kontekst, qeveria shqiptare miratoi me vendimin 480 datë 31.07.2018 Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030. Strategjia ka parashikuar këta skenarë zhvillimi:

- i) skenari i zhvillimit të efikasitetit të energjisë,
- ii) skenari i zhvillimit të efikasitetit të energjisë dhe energjive të rinovueshme.
- iii) Promovimi i gazit natyror,
- IV) integrimi elektroenergjetik Shqiperi-Kosovë,
- v) Skenari i kombinuar: Ky skenar kombinon skenarët EE, BRE dhe të promovimit të gazit natyror.

Me qëllim rritjen e kërkesës për energji deri në 2020, 2030, 2040 dhe plotësimin e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të strategjisë së traktatit, strategjia vlerëson se skenari me efikasitet dhe energji të rinovueshme do të kërkojë ndërtimin e kapaciteteve të reja nga hidro-energji dhe termo-energji. Përveç HEC-eve në listë janë TEC- i Vlorës, TEC- i i Korçës, TEC-i i Durrësit, TEC-i i Kuçovës.

Strategjia përcakton se konsumi final i energjisë për vitin 2013 ishte 2071 ktne nga ku 561 ktne nga HEC-et vendase dhe energji elektrike e importuar dhe pjesa tjetër nga nafta, nënproduktet, gazi biomasa, lëndë drusore. Ndërsa kërkesa për energji deri në 2020 parashikohet të jetë 2,675 ktne dhe në 2030 do të jetë 3,870 ktne (kilo ton naftë ekuivalent).⁶

Konsumi final i energjisë në 2013 është 2,071 ktne dhe elektriciteti (HEC-e dhe importi) përbën 27%. Nga këto 14% vjen nga importi dhe 13% prodhohet nga HEC-et e brendshëm.

Tabela 8-9 Furnizimi Total me Energji në ktne sipas burimet primare për vitet 2020-2040

⁵ Përllogaritur nga autori

⁶ 1ktne = 11630 MWh

	2013	2020	2025	2030	2035	2040
Energjia prodhuar nga HEC-et	253	610	764	822	885	950
Energjia importuar	308	299	159	190	237	320
Total (ktne)	561	909	953	1012	1122	1270
Total (giga vat orë)	6.5	10.57	11	11.8	13.04	14.8

Ndërsa sipas skenarit të efikasitetit të energjisë në transmetim, shpërndarje dhe prodhim dhe vënien në punë të TEC-it të Vlorës parashikohet që deri në 2040 elektriciteti do të përbëjë 25% të konsumit të energjisë dhe nga këto vetëm 6% do të vijë nga importi. Pjesa tjetër prej 19% nga HEC-et në vend.

Pra objektivi i strategjisë është i qartë: Reduktimi i varësisë së importit përmes rritjes së prodhimit të energjisë nga HEC-et vendase.

2.1.1. Master Plani për zhvillimin e gazit natyror në Shqipëri

Qeveria miratoi Planin e Zhvillimit të gazit me VKM nr. 87, datë 14.2.2018, ku ka identifikuar dhe projektet strategjike dhe kërkesën për gaz natyror në vend. Strategjia Kombëtare e Energjisë e përditësuar përcakton se kërkesa për gaz deri në 2030 do të jetë 1.5-1.8 mmk gaz në vit. Master Plani parashikon dhe ndërtimin e TEC-eve me gaz në Korçë, Kuçovë dhe Vlorë. Sipas master planit të gazit mendohet se deri në 2040 do të konsumohet 437.4 mmk gaz për prodhim energjie. Specifikisht energjia e prodhuar nga gazi do jetë aktive në 2020 me 27 ktne deri në 193 ktne në 2040. Kjo do të përkthehet që Shqipëria në 2030 nuk do të importojë më energji nga jashtë duke filluar reduktimin që nga 2025 me vetëm 29 ktne. E shprehur në shifra 317 Milionë EUR. Në 2013 u shpenzuan: EUR **288,191,400**.⁷[SKE, 2015-2030; MPG, 2018; PPBRE, 2018]. Energjia diellore, gjeotermike, e erës etj. do të zërë vetëm **2%** të totalit të energjisë, ose 27 ktne në 2020 dhe 99 ktne në 2040.

2.1.2 Plani kombëtar për energjitë e rinovueshme 2015-2020

Më 20 janar 2016, u miratua Plani Kombëtar për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKBRE) në Shqipëri 2015-2020. PKBRE do të mundësojë arritjen dhe zbatimin e ligjit për energjitë e rinovueshme si obligim ndaj direktivës përjasur me ligjin 138/2013. Ky plan përveçse paraqet objektivat kombëtare përcakton dhe mjetet dhe rrugën për arritjen e

⁷ Statistika të marra nga burimet zyrtare

tyre. Vendi ynë e prodhon energjinë 100% nga impiantet e hidroenergjisë dhe importon – në bazë të vitit dhe reshjeve nga 30-60% të energjisë primare. Për të zvogëluar këtë hendek të madh, plani PKBRE parashikon se zhvillimi i energjive të rinovueshme do të krijojë siguri energjetike dhe të përmirësojë stabilitetin makro-ekonomik që krijohet nga ky hendek.

Si e tillë objektivat kryesore të planit janë:

Konsumi i energjive nga burime të rinovueshme në masën 38% deri në 2020;

Diversifikimi i burimeve të rinovueshme të energjisë jo vetëm nga hidro-energja por nga dielli, era, biomasa dhe energjia termale dhe përdorimi i burimeve vendase në zonat rurale. Dhe rritja e kontributit të bio-karburanteve deri në 10% deri në 2020.

Objektivi 38% u miratua në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitet të Energjisë 2012/04/MC-EnC, duke u bërë një detyrim i vendit tonë. Me qëllim matjen e progresit të vendit në këtë drejtim, TKE përgatit progres raportet për vendet. Raporti i prezantuar në janar 2017 për vitin 2014-2015 në Shqipëri dëshmoi se Shqipëria nuk mund ta arrijë objektivin deri në 2020. Raport progresi shprehet qartë se Shqipëria, duhet të marrë masa për rritjen e investimeve me projekte për energjitë e rinovueshme **përveç hidro-energjisë** dhe të sjellë besimin e investitorëve në treg.

2.1.3 Plani kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020

Përmes vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 1.12.2017, qeveria shqiptare ka përcaktuar objektivat dhe zbatimin e tyre për eficiencën energjetike. Plani vjen jo vetëm si detyrim ndaj objektivave të ndërmarra si pjesë e traktatit të komunitetit të energjisë por edhe si mjet për zbatimin e objektivave të përcaktuara në SKEZHI II. Në të vërtetë në planin e parë të EE 2011-2018 nuk u arritën detyrimet e përcaktuar në të siç ishin: miratimi i një ligji, krijimi i strukturave përkatëse të eficiencës si agjencia e dedikuar për eficiencën e energjisë, apo një fond i posaçëm për promovimin dhe financimin e projekteve. Plani i ri parashikon ti realizojë këto detyrime edhe pse aktualisht përveçse miratimit të anës ligjore, në praktikë nuk ka lëvizur asgjë. Ulja e emetimeve të CO₂ është një tjetër detyrim që rrjedh nga Objektivi Kombëtar i Pikësnyuar ose siç njihet Marrëveshja e Parisit. Njëkohësisht plani parashikon një rritje prej 2.2% të konsumit të energjisë elektrike me reference vitin 2015, duke reduktuar me 11% konsumin për lëndë drusore dhe 10% gazin e lëngshëm.⁸ 6.6 milionë² sipërfaqe në ndërtesa për të rritur performancën energjetike të ndara sipas klimës A, B dhe C. Plani i ri fokusohet në kursimin e energjisë në tre sektorë (industrisë, transportit dhe ndërtesave). Objektivi 6.8% deri në 2020 duket si i arritshëm nga mbështetja e qeverisë. Objektivi deri në 2018 me 9% ose 168 ktoe është 10 herë më i lartë sesa u reduktua në 2015 me 16.4 ktoe. PKVEE parashikon se kosto totale e investimeve vetëm publike në harkun kohor 2018-2020 për arritjen e objektivave është afërsisht 14.236.000.000 Lekë⁹. Megjithatë, prapë objektivi prej 9% është i paarritshëm nga qeveria.

2.1.4 Raporti vjetor i zbatimit të Traktatit të Energjisë - 2017

⁸ PKVEE, fq 5

⁹ Po aty, fq.214

Neni 52 i Traktatit të Energjisë përcakton se Këshilli Ministerial do të përgatisë një raport vjetor për aktivitetin e Komunitetit të Energjisë pranë Parlamentit Evropian dhe parlamenteve të Palëve Aderuese dhe të Pjesëmarrësve. Në këtë kontekst, raporti vjetor merr në shqyrtim afërisht 19 direktiva dhe 8 rregullore të BE-së përmes 23 treguesve për të matur progresin vs. regresin në sektorët përkatës. Në 2016, Këshilli i Ministrave adaptoi katër vendime duke e zgjeruar mbrojtjen mjedisore të aktiviteteve energjetike. Specifikisht, për interesin e këtij studimi vendimet përditësojnë direktivën për VNM dhe VSM duke i dhënë një mbrojtje më të lartë mjedisit. Megjithatë raporti, vlerëson se Shqipëria nuk do ta arrijë objektivin e përcaktuar me 38% deri në 2020. Përveçse ndihmës shtetërore në hidrocentrale, qeveria nuk ka marrë asnjë masë për ndihmën shtetërore sipas Udhëzimeve për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë 2014-2020)¹⁰.

2.2 Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore, 2017-2027

Shqipëria është shumë e pasur me burime ujore, duke përfshirë si ujërat sipërfaqësorë ashtu edhe ato nëntokësorë, me sasinë më të lartë të ujit të disponueshëm për frymë tek 8,700 m³/vit. Ndonëse Shqipëria ka burime të mëdha ujore, përdorimi dhe shfrytëzimi i këtyre burimeve ka vuajtur nga administrimi i papërshtatshëm dhe jo eficient i ujit. Sektori i ujit është menaxhuar në mënyrë të fragmentuar nga disa institucione që kishin lidhje me ujin, shpesh me një mbivendosje të përgjegjësive. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore, 2017-2027 (SKMIBU) është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse. Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si “një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore”. MIBU në vend do të arrihet nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, ekonomik, institucional, teknike dhe sociale duke u bazuar në legjislacionin Evropian për mjedisin dhe parimet e MIBU-s. Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër ‘shtylla’ strategjike: ‘Ujë për Njerëzit’, ‘Ujë për Ushqim’, ‘Ujë për Industrinë’, dhe ‘Ujë për Mjedisin’. Strategjia MIBU përcakton 5 Objektiva Strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë:

1. **Sasia e Ujit:** sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
2. **Cilësia e Ujit:** sigurimi i një cilësie të mirë të ujit, të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e “gjendjes së mirë të ujit” deri në vitin 2027, nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
3. **Rreziqet nga Uji:** ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësira) përmes menaxhimit dhe investimeve, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;

¹⁰ ECt, Annual Implementation report 2017, pg.39

4. **Informacion për Ujin:** sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar mbi këto të dhëna dhe modele;

5. **Administrimi i Ujit:** menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe të BE-së.

Duke zbatuar Strategjinë MIBU, Shqipëria do të bëhet një vend me efikasitet ujore, me një menaxhim funksional të integruar të burimeve ujore, ku përdorimi i ujit mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë dhe barazisë për përfitime ekonomike të barabarta sociale-gjinore dhe **drejtësi mjedisore për të sotmen dhe për brezat e ardhshëm**. Parashikimet e strategjisë janë që deri në 2050 vendi do ketë 14% më pak burime ujore si pasojë e ndryshimeve klimaterike, rritjes së temperaturave, zvogëlimit të periudhës së reshjeve. Për këtë arsye strategjia ka bërë për herë të parë një **bilanc ujor** për të matur gjendjen aktuale të ujit sot dhe në të ardhmen, kërkesat e përdoruesve kryesore (ujë për bujqësinë, ujë për industrinë dhe hidro-energjinë dhe ujë të pijshëm). Nga bilanci del se Shqipëria ka një bilanc të mirë ku konsumi është shumë herë më i ulët sesa prodhimi. Kjo për arsye se hidroenergji konsiderohej sektor pa konsum neto pasi uji që merret në turbina shkarkohet sërish në basen, e kundërta ndodh me bujqësinë ku uji avullon. Megjithatë, mungon një bilanc i saktë i ujit përsa i përket mjedisit dhe biodiversitetit. Në këtë rast sasia llogaritet si Q₃₆₅ ditë.

2.2.1 . Draft - Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030

Draft plani kombëtar sektorial (PKS) i ujit është dokument i plotë i cili shpreh vullnetin e qeverisë për përmirësimin e sektorit nga shumë aspekte. PKS është i fokusuar në tre shtylla kryesore: përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit, mbrojtja nga uji. PKS ka hartuar vizionin e saj dhe 13 objektiva strategjike. Objektiva nr. 6 i referohet prodhimit të hidroenergjisë. Sipas këtij objektivi është vizioni i qeverisë që deri në 2020 hidro-energji të shfrytëzoje 80% të burimeve ujore në krahasim më 45% që ishte në 2015. Objektivi 80% qëndron i pandryshuar dhe për 2025 apo 2030. Në këtë kontekst, presioni ndaj burimeve ujore do të jetë në rritje dhe jo në ulje. Në funksion të studimit dhe analizës sonë në PKS të ujit një nga format kryesore në ofrimin e shërbimeve është kryesisht në fushën e hidroenergjisë nëpërmjet kontratave koncesionare. Tabela më poshtë paraqet informacion lidhur me kontratat koncesionare dhe numrin e HEC-ve duke filluar nga viti 2002 dhe në vazhdim si dhe vlerën e investimeve të tyre bazuar në Ligjin Nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar. Të dhënat tregojnë se që prej vitit 2002 e deri tani janë 502 HEC-e nga ku 65% e tyre nuk kanë filluar ende punimet, 15% janë HEC-e në ndërtim dhe pjesa tjetër me 20% janë HEC-e të cilat prodhojnë energji. Vlera totale e këtyre investimeve është 313.45 miliardë lekë.

Numri i HEC-ve që nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore	Vlera e parashikuar e investimeve për HEC-t që nuk kanë filluar ende punimet ndërtimore (në Lekë)	Numri i HEC-ve në ndërtim	Vlera e parashikuar e investimeve për HEC-t në ndërtim	Numri i HEC-ve në prodhim energjie	Vlera e investimeve për HEC-t që prodhojnë energji
327	161.6 mld	73	127.35 mld	102	24.5 mld

Megjithëse PKS ka parashikuar se deri në 2020-2030 do të shfrytëzohen 80% të rezervës hidrike për hidro-energji, nuk përcakton se ku do të prodhohet kjo energji, në cilin segment lumor dhe basen dhe cilët do të jenë segmentet e paprekur. Duke qenë se 65% e HEC-eve nuk kanë filluar punimet mund të jetë me vend ndërhyrja në këtë moment. Me interes, në PKS paraqitet dhe ndërtimi i një strukture studimore-kërkimore për parashikimin e një tarife që rrjedh nga hidro-energji në funksion të mjedisit dhe mbrojtjes së tij që shkaktohet nga prodhimi. **Megjithatë kjo parashihet për në vitin 2021.**

2.2.2 Planet e Menaxhimit të Basenit Lumor

Zhvillimi i hidro-energjisë duhet të marrë parasysh ndërveprimin e burimit dhe derdhjes së lumit, përtej kufijve administrative apo politikë. Në këtë perspektivë, zbatimi i Direktivës Kuadër të Ujit të BE e shprehur me ligjin 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, është një pjesë e rëndësishme e legjislacionit drejt rrugës për në BE pasi gjithë burimet ujore kërkojnë zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve. Këto plane duhet të ofrojnë një hap të parë themelor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në nivel baseni lumor për zhvillim të **qëndrueshëm të prodhimit të hidro-energjisë. Planet do të lejojnë një vlerësim të saktë të kapacitetit të hidro-energjisë në basen dhe një vlerësim të efektit kumulativ të infrastrukturës ekzistuese dhe projekteve të ardhshme.** Konkretisht, nga gjashtë basene ujore që ka vendi, Drin-Buna, Seman, Vjosa, Ishëm-Erzen, Shkumbini dhe Mati, nuk kemi asnjë plan menaxhimi të miratuar dhe masa përkatëse zbatimi. Përpjekja e bërë më herët për një plan menaxhimi të Semanit nuk është miratuar kurrë, pasi siç shprehet qartë në Strategjinë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore: *“Shumë herët për PMBU të plota sipas BE-së për shkak të mungesës së njohurisë ekologjike dhe të dhënave të monitorimit. Duhet të merret një vendim për shfuqizim. Duhet të kërkohet pëlqimi i BE-së”*.¹¹

2.3 Drat strategjia ndër-sektoriale e mjedisit 2015-2020

Draft strategjia e përcakton Shqipërinë si “Vend me një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vënë ato në përfitim të prosperitetit ekonomik”. Ky vizion mbështetet në parimin e zhvillimit të integruar ku mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së medimeve mjedisore garanton

¹¹ Fq.118

sigurinë e rritjes ekonomike dhe mirëqenien sociale. Objektivat që synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe të mbështetura edhe në politikat ndërsektoriale të mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë:

Të realizohet mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave nëpërmjet zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda vitit 2020;

- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MM;
- Rehabilitimi i shtretërve të dëmtuar të lumenjve me 25% deri në vitin 2020;
- Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me qëllim reduktimin me 95% krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre;

Megjithatë, draft strategjia nuk u miratua pasi në gjykimin e departamentit të koordinimit të strategjive pranë Këshillit të Ministrave numri i lartë i strategjive shkonte përtej tavanit të lejuar dhe mjedisi është ndërsektorial, çka e bën mbrojtjen e tij të integruar në strategjitë e tjera.

2.4 Draft - strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018 – 2022

Në janar 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur konsultimin e draft startegjisë për turizmin. Sipas të dhënave kryesore, të kësaj draft startegjie viti 2017 u mbyll me mbi 1.5 miliardë Euro të ardhura nga turizmi dhe mbi 5 milionë vizitorë të jashtëm në Shqipëri, shifra këto rekorde që kontribuan ndjeshëm në rritjen vjetore ekonomike 4% të vendit. Turizmi kështu u rikonfirmua si nxitësi kryesor i rritjes së ekonomisë së vendit. Dekada e ardhshme do të jetë ajo e turizmit, me synimin që në vitin 2027 kontributi total i sektorit të jetë 33% në PBB, dhe çdo i treti i punësuar të jetë në turizëm dhe shërbimet ndërlidhëse. Si rezultat, turizmi shihet si sektor strategjik përmes të cilit Shqipëria mund të arrijë rritje të qëndrueshme afatgjatë dhe konkurrueshmëri, duke siguruar mbrojtje efektive të mjedisit. Gjatë vitit 2016 kontributi direkt i turizmit në PBB e vendit tonë ka qenë 127.7 miliard Lekë, duke zënë kështu 8.4% në PBB të vendit. Gjatë vitit 2016 kontributi total i turizmit në PBB e vendit tonë ka qenë 393.0 miliard Lekë, duke zënë kështu 26% në PBB të vendit. Në krahasim me një vit më parë ky kontribut është rritur me 86.8 miliard lekë. Sipas Bankës së Shqipërisë, të ardhurat nga udhëtimi/ turizmi për këtë vit kanë shënuar një rritje prej 13% krahasuar me një vit më parë. Në shifra kjo rritje është nga 1.353 milion Euro në 1.528 milion Euro.

Ndërsa të ardhurat vetëm nga turizmi natyror në zonat e mbrojtura ka qenë 2.041.916 vizitorë.

III. ANALIZA E BOSHLLËQEVE

III.1 - TABELA E PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN BE¹²

	Ligji/Akti nënligjor	Direktiva referuese	Niveli i Përputhshmërisë	
A	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, ndryshuar me Ligjin Nr.88/2014 dhe Ligjin Nr.77/2015	Direktiva 2004/18/EC (shfuqizuar)	I pjesshëm	
		Direktiva 2014/23/EC	I papërafruar	
	VKM nr. 575 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ppp” datë 10.07.2013, ndryshuar me VKM nr. 313 datë 27.04.2016 dhe me VKM Nr. 146, datë 22.2.2017	Direktiva 2004/18/EC (shfuqizuar)	I pjesshëm	
		Direktiva 2014/23/EC	I papërafruar	
B	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”	Direktiva 2004/35/EC amenduar nga Direktiva 2006/21/EC	I pjesshëm	
		Direktiva 2001/42/EC (VSM)	I plotë	
		Direktiva 2011/92/EU (VNM)	I plotë	
		Direktiva 2003/4/EC	I plotë	
	Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”	VKM nr. 419, datë 25.06.2014	Direktiva 2010/75/EU që shfuqizon me efekt nga data 7 Janar 2014 Direktivën 2008/1/EC	I pjesshëm
	Ligji nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”		Direktiva 92/43/EEC	I pjesshëm
			Direktiva 97/62/EC Direktiva 2006/105/EC Rregullorja 1882/2003/EC	I papërafruar

¹² Referuar VKM nr. 42, datë 25.1.2017 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020"

	Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 69/2014	Direktiva 2009/147/EC Direktiva 92/43/EEC	I pjesshëm
	Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”	Direktiva 2009/147/EC Direktiva 92/43/EEC Direktiva 1999/22/EC Rregullore EEC/3254/91 Direktiva 83/129/EEC	I pjesshëm
	VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin evropian”	Direktiva 92/43/EEC	I pjesshëm
C	Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)” VKM nr. 219, datë 11.03.2015 VKM nr. 620, datë 07.07.2015	Direktiva 2001/42/EC	I pjesshëm
	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)”, i ndryshuar nga Ligji nr.12/2015 VKM nr. 247, datë 30.04.2014 VKM nr. 598, datë 01.07.2015 VKM nr. 686, datë 29.07.2015	Direktiva 2011/92/EU Direktiva 2014/52/EU e cila ka amenduar Direktivën 2011/92/EU	I pjesshëm I papërafruar
	Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” VKM nr. 994, datë 02.07.2008 VKM nr.16, datë 04.01.2012 VKM nr. 247, datë 30.04.2014	Direktiva 2003/35/EC Direktiva 2003/4/EC	I plotë

	Urdhëri i Ministrit nr. 1, datë 03.03.2009		
D	Ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”	Direktiva 2000/60/EC amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC	I plotë
		Direktivat 2013/39/EU, 2013/64/EC dhe 2014/101/EU që kanë amenduar Direktivën 2000/60/EC	I pjesshëm
	VKM nr. 177, datë 26.03.2014 VKM nr. 246, datë 30.04.2014 VKM nr. 267, datë 07.05.2014 VKM nr. 416, datë 13.05.2015 VKM nr. 342, datë 04.05.2016	Direktiva 2000/60/EC amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EC dhe 2014/101/EU	I pjesshëm
E	Ligji 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”	Direktiva 2009/28/KE	I pjesshëm

III.2 GJETJE DHE REKOMANDIME NË LIDHJE ME PLANET DHE STRATEGJITË

Gjetje 1: Të gjitha strategjitë/planet dhe raportet e shprehin qartë së Shqipëria duhet të ndjekë rrugën e përcaktuar në këto plane për **diversifikimin e energjisë** përtej hidro-energjisë. Kjo jo vetëm për arritjen e objektivave specifike por dhe sigurinë energjetike, dhe mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kontekst është e paqartë dhe e dyshimtë pse institucionet si Ministria e Energjisë dhe autoritetet që licencojnë koncesione në këtë fushë nuk ndjekin programin dhe planet strategjike në këtë drejtim?!

Gjetje 2: Planet e menaxhimit të baseneve janë hallka e vetme por më rëndësishmja që bën rregullimin e strategjive dhe planeve kombëtare në projekte të zbatueshme në nivel baseni. Këto plane nuk janë hartuar, dhe fatkeqësisht nuk janë nisur pasi siç shprehet qartë në startegjinë e ujit “mungon informacioni i plotë ekologjik në basen nga monitorimi dhe nuk mund të zbatohen”.

Gjetje 3: Është e paqartë nga analiza e dokumenteve strategjike kush është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të aspekteve të shumta si (turizmi, ujitja, peshkimi, përmbytjet, energjia etj) për planifikimin e prodhimit të hidro-energjisë, pasi është shumë e vështirë për të analizuar përfitimet e projektit vetëm nga vlerësimi i prodhimit të energjisë. Oponenca Teknike brenda AKBN-së është e pamjaftueshme, shpesh e pamundur dhe jo shumë e hapur për transparencën publike. Ndërsa Këshilli Kombëtar i Territorit, që do duhej ta luante këtë rol në analizën e përfitimit ekonomike kundrejt efekteve anësore para licensimit përfundon në numra votash dhe rrallëherë ndodh e kundërta.

Gjetje 4: Në 2005 raporti i popullsisë ishte 47% urbane dhe 53% rurale ndërsa në 2015 raporti është 57% urbane dhe 43% rurale. Në kërkesat për ujë (ujë për bujqësinë) ky faktor ka dominuar për koncesionet pa u përballur me konfliktet ujore duke filluar fillimisht në zonat e shpopulluara. Në kohën kur koncesionet iu afruan zonave të banuara rurale atëherë vërehet një rritje e konflikteve të hapura.

Gjetje 5: Në 2016 të ardhurat nga turizmi ishin 1.528 milion Euro duke përfshirë udhëtimet dhe turizmi. Kontributi direkt në PBB ishte 8.4% ndërsa ai total në 23.3%. Kontributi në punësim ishte 85,000 vende pune (7.7%) dhe indirekt 267,000 vende pune (23.9%). Në të njëjtin vit kontributi në ekonominë e vendit nga sektori energjetik (prodhim, transmetim, shpërndarje) ishte 441 milionë USD, nga të cilat 71.4% i referohen kontributi nga hidrocentralet në kaskadën e Drinit. Në 2016 kontributi në punësim nga sektori hidro-energjetik ishte 1%.

Gjetje 6: PPK si dokument më i lartë politik, ligjor dhe ekonomik e përcakton qartë krijimin e parkut kombëtar të Vjosës. Strategjia e turizmit e shikon turizmin natyror si element të rëndësishëm për rritjen e numrit, PBB, produkt të ri turistik. Në këtë këndvështrim, futja e hidrocentraleve në lumin e Vjosës dalin jashtë planeve kombëtare, sektoriale dhe propozohen si produkt i vetëm i një sektori.

Gjetje 7: Në 2013 konsumi total i energjisë ishte 7,957,698 ndërsa në 2016 ishte 7,094,576 ose 11% më pak se në 2016. E gjithë kërkesa në 2016 u përballua nga prodhimi vendas me

një bilanc pozitiv prej plus 42 MWh.¹³ E gjithë energjia është prodhuar nga Kaskada e Drinit plus 139 HEC-e private me një kapacitet prej 561 MW.

Gjetje 8: Kapaciteti i instaluar deri në 2016 është i mjaftueshëm për gjenerimin e energjisë që kërkohet për konsumin vendas. Kërkesa në rritje sipas viteve do të mbulohej më së miri nga infrastruktura e gazit natyror me TAP-in, ku vetëm në 2019 do të futej në fuqi TEC-i i Vlorës me 98 MW. Ndërtimi i HEC-eve të tjera nuk justifikon arsyetimin e koncesioneve për çështje të furnizimit, por më së shumti për çështje të pavarësisë energjetike. Megjithatë, koncepti i pavarësisë energjetike në një sistem të varur nga reshjet nuk ekziston.

Gjetje 9: Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” në nenin 16, u ka përcaktuar detyrim ministrive përgjegjëse që brenda një afati 7 vjeçar nga miratimi i ligjit të hartojnë programet e menaxhimit dhe veprimet për të mbajtur apo rivendosur statusin e favorshëm të ruajtjes së ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, të ekosistemeve, habitateve apo peizazheve veçanërisht të mbrojtura, si dhe të atyre të degraduara, të cilat miratohen nga ministri dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Nga ana tjetër, neni 17/2 parashikon që Ministria duhet të përzgjedhë një listë të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojet, në çdo rajon përkatës biogeografik, me qëllim propozimin Komisionit Europian të listës së zonave, të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh.

Rekomandim 1: Adresimi i çështjes së diversifikimit të energjisë së rinovueshme pranë Komunitetit të Energjisë dhe presionin ndaj Shqipërisë për të zbatuar objektivat e veta.

Rekomandim 2: Lobimi dhe avokatia ndaj Ministrisë së Energjisë dhe Ministrisë së Mjedisit, që të pezullojë lejet e ujit dhe mjedisit në basenet ujore pa u miratuar planet e menaxhimit dhe saktësisht se cilat janë kapacitetet ujore, në cilat zona dhe si do ndërtohet.

Rekomandim 3: Meqenëse shteti nuk e ka realizuar ende detyrimin që i ka vendosur vetes për evidencimin e ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, të ekosistemeve, habitateve apo peizazheve veçanërisht të mbrojtura, si dhe të atyre të degraduara dhe hartimin e planeve të menaxhimit të tyre, është e nevojshme që para dhënies së lejeve për hidrocentrale të reja, të realizohet një studim kombëtar mbi llojshmërinë dhe biodiversitetin e faunës së egër në mjediset lumore ujore.

III.3 GJETJE DHE REKOMANDIME NË LIDHJE ME KUADRIN LIGJOR DHE NËNLIGJOR

Gjetje 1:

Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve, ka parashikuar në nenin 5 (1) se *“Dhënia e një koncesioni punësh apo shërbimesh do të përfshijë transferimin tek koncesionari të një rreziku operativ në shfrytëzimin e këtyre punëve apo shërbimeve që përfshijnë rrezikun e kërkesës*

¹³ ERE, 2016, fq.79

apo të furnizimit ose të dyja bashkë. Koncesionari do të konsiderohet se merr përsipër riskun operativ, kur në kushte normale të operimit, ai nuk e ka të garantuar mbledhjen e investimit apo shpenzimeve të bëra në funksion të punimeve apo shërbimeve objekt koncesioni. Pjesa e rrezikut e transferuar tek koncesionari do të përfshijë ekspozimin e vërtetë tek luhatjet e tregut, në mënyrë të tillë që çdo humbje potenciale e ndeshur nga koncesionari nuk do të jetë thjesht nominale ose e papërfillshme"

Në nenin 3, pika 5 të Ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" është përkufizuar si vijon: "E drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet" ka kuptimin e mëposhtëm: a) e drejta për të nxjerrë të ardhura, në përputhje me kontratën e koncesionit; si dhe b) transferimi te koncesionari i një pjese të konsiderueshme të riskut operacional, që lidhet me objektin e një koncesioni të punëve publike ose të shërbimeve publike. Do të quhet se koncesionari ka marrë një pjesë të konsiderueshme të riskut operacional, në qoftë se mbështetja financiare e dhënë direkt ose indirekt nuk garanton se do të realizojë kthimin e investimit apo mbulimin e kostove që rezultojnë nga menaxhimi i punëve dhe/ose i shërbimeve, të cilat janë objekt i koncesionit. Risku operacional ka kuptimin e riskut, që lidhet me përdorimin e veprave ose ofrimin e shërbimeve ose riskun që lidhet me disponueshmërinë e objektit të infrastrukturës që ndërtohet ose përdoret për të siguruar shërbime për përfituesit fundorë, në përputhje me kontratën e koncesionit".

Rekomandim: Meqënëse Ligji nr. 125/2013 nuk e përkufizon në përputhje me rregullimin e Direktivës 2014/23/EU as përkufizimin e konceptit të rrezikut operativ dhe as detyrimin që një rrezik i tillë duhet të merret përsipër nga koncesionari, kjo mund të realizohet duke u ndryshuar neni 3, pika 5 e Ligjit 125/2013.

Gjetje 2:

Neni 37 i Ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", normon mënyrën se si do të rregullohen marrëdhëniet e pronësisë dhe të drejtat e lidhura me të në projektet koncesionare/partneritet publik privat (PPP), si vijon: "1. Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar. 2. Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, ose nëse koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e të mirave publike, atëherë autoriteti kontraktues zgjidh të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar."

Nga ana tjetër, në mënyrë të përgjithshme dhe evazive, neni 29 (3) i Ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që përcakton se: "Shuma dhe afatet e pagesës së tarifës së koncesionit përcaktohen në përpjesëtim me objektin e koncesionit, me vlerën e parashikuar të kontratës së koncesionit, kohëzgjatjen e kontratës, risqet dhe kostot që koncesionari merr përsipër dhe fitimin e pritshëm, **si dhe me nivelin e pajisjeve dhe vlerën e pronës së dhënë, sipas kontratës së koncesionit nga autoriteti kontraktues.**", ka

parashikuar që në ato raste kur aplikohet, tarifa e koncesionit do të marrë në konsideratë ndër të tjera edhe shfrytëzimin nga ana e koncesionarit të pajisjeve dhe pronës së dhënë në përdorim nga autoriteti kontraktues, pa specifikuar nëse bëhet fjalë për pronë publike dhe/ose pronë private që do të shpronësohet për tu përdorur për realizimin e objektit të koncesionit, apo për pajisje dhe prona të autoritetit kontraktues që do të vihen në dispozicion të koncesionarit për nevoja operationale dhe administrative.

Një sërë dokumentash udhëzuese të organizatave ndërkombëtare të konsideruara si udhërryfes të praktikave më të mira për organizmin e projekteve koncesionare/PPP, si p.sh. *Udhëzimi Referues i Bankës Botërore për PPP (PPP Reference Guide - Version 3 2017)*; *Udhëzimi legjislativ mbi Projektet e Financuara Privatist të United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) (Legislative Guide on Privately Funded Infrastructure Projects - 2000)*; dhe *Parimet e OSBE mbi Administrimin Publik të PPP (OECD Principles for Public Governance of Public-Private Partnerships - 2012)*, i japin të gjitha një rëndësi të vecantë nevojës që, legjislacioni për koncesionet/PPP duhet të përmbajë përcaktime të sakta, të qarta dhe të plota mbi mënyrën se si do të rregullohen marrëdhëniet e pronësisë dhe të drejtat e lidhura me të si e drejta e përdorimit dhe ajo e kalimit, në raport me pasuritë publike apo private që i vihen në dispozicion operatorëve ekonomikë në një projekt koncesioni/PPP.

Për më tepër, udhëzuesit e mësipërm i konsiderojnë rregullimet e mësipërme ligjore jo vetëm si mënyra të përcaktimit të qartë të risqeve të përfshira në projekt dhe garanci të nevojshme për operatorin ekonomik, por edhe si përmbushje të detyrimeve të autoriteteve publike në drejtim të menaxhimit të impakteve sociale siç mund të jenë ato që shkaktohen nga zhvendosjet e popullsisë në territoret që preken nga zbatimi i projektit koncesionar/PPP. Aktualisht, i vetmi legjislacion që rregullon shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pronës private për interes publik është Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, por dispozitat e neneve 37 dhe 29 të Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, nuk reflektojnë dhe nuk referojnë në mënyrë korrekte dhe të qarta rregullimet e këtyre akteve ligjore dhe nënligjore specifike.

Rekomandim: Për të shmangur abuzime si dhe për ti dhënë siguri të gjitha palëve që preken nga dhënia e një koncesioni si publikut për pasuritë publike, operatorit ekonomik ashtu edhe pronarëve privatë të pasurive të përfshira, është e nevojshme që parashikimet e neneve 37 dhe 29 të Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të rishikohen duke përfshirë në mënyrë specifike në përkufizimin për tarifën e koncesionit dhe konceptin e një pagese nga koncesionari për ahfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme që do të përdoret në funksion të objektit të koncesionit.

Gjetje 3:

Neni 16 i Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, përcakton veprimet për dhënien e koncesionit/ partneritetit publik privat duke parashikuar që: “1. Veprime për dhënien e një koncesioni/ partneriteti publik privat quhen të gjitha aktivitetet e

ndërmarra që nga identifikimi i projekteve deri në fazën e monitorimit të kontratës në zbatim të këtij ligji. 2. Autoriteti kontraktues mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen dhe dhënien e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat. 3. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të pikës 1 të këtij neni.”, ndërsa neni 17 (1) i këtij Ligji përcakton “Autoriteti kontraktues identifikon dhe shqyrton projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat brenda sferës së kompetencave të tij.”

Në dokumentat udhëzuese të organizatave ndërkombëtare të konsideruara si udhërryfes të praktikave më të mira për organizmin e projekteve koncesionare/PPP, si p.sh. *Udhëzimi Referues i Bankës Botërore për PPP (PPP Reference Guide - Version 3 2017); Udhëzimi legjislativ mbi Projektet e Financuara Privatisht i United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) (Legislative Guide on Privately Funded Infrastructure Projects - 2000); Parimet e OSBE mbi Administrimin Publik të PPP (OECD Principles for Public Governance of Public-Private Partnerships - 2012); dhe Udhëzuesi i Qendrës Europiane të Ekspertizës për PPP (The European PPP Expertise Centre (EPEC)), një rëndësi thelbësore i jepet përcaktimit të qartë dhe të plotë në legjislacionin për koncesionet/PPP të etapave dhe proceseve nëpër të cilat duhet të kalojë një projekt koncesioni/PPP, duke filluar nga vendimmarrja e prioritizuar në nivel politikash, planesh e strategjish, identifikimi i projekteve eventuale, vlerësimi, studimi dhe strukturimi i projektit, procedurat për dhënien e kontratës dhe menaxhimi i kontratës.*

Në mënyrë specifike këto udhëzues rekomandojnë që: *“Standartizimi i procesit të PPP, ndihmon në garantimin që të gjitha projektet e PPP të zhvillohen në një mënyrë që është në përputhje me objektivat qeverisëse... procesi i zhvillimit dhe zbatimit të një PPP, si rregull duhet të paraprihet nga identifikimi i projektit të investimit si një prioritet publik”¹⁴, si dhe “Të gjitha projektet e investimeve duhet të prioritizohen në nivel të lartë politik. Meqënëse ka shumë priorite investuese konkurruese, është përgjegjësi e qeverisë të përcaktojë dhe ndjekë realizimin e objektivave strategjike. Vendimi për investime duhet të bazohet në tërësinë e perspektivës qeverisëse dhe të jetë i ndarë nga vendimi mbi mënyrën e prokurimit dhe financimit të projektit.”¹⁵*

Rekomandim: Në kushtet aktuale as neni 16, as neni 17 dhe as ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit 125/2013, nuk ka përcaktuar si detyrim që identifikimi i projekteve të mundshme koncesionare/PPP duhet të bëhet duke u mbështetur në strategjitë, planet apo programet e miratuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe as nuk parashikon nevojën për miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave për nisjen e një projekti të tillë. Kjo krijon hapësira për ushtrim të një pushteti diskrecial nga autoritete të ndryshme publike që rrezikon në të shumtën e rasteve vendimmarrje për të realizuar koncesione/PPP, të cilat nuk janë të inkuadruara në politikat qeverisëse dhe planet e programet strategjike të nivelit kombëtar. Pra është e nevojshme që mbështetja dhe referimi në strategjitë, planet dhe programet kombëtare të miratuara rregullisht sipas ligjit, të jetë një parakusht i

¹⁴ *Udhëzimi Referues i Bankës Botërore për PPP (PPP Reference Guide - Version 3 2017)*

¹⁵ *Parimet e OSBE mbi Administrimin Publik të PPP (OECD Principles for Public Governance of Public-Private Partnerships - 2012)*

detyrueshëm ligjërisht për fillimin e një procedure koncesioni/PPP, nëpërmjet përfshirjes së një neni të veçantë në ligj për këtë qëllim.

Gjetje 4:

Neni 19 i i Ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", përcakton rregullat se si, kur dhe nga kush do të hartohet studimi i fizibilitetit të koncesionit/PPP dhe çfarë duhet të përmbajë: *"1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin/ partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncesionit/ partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga krijimi i këtij komisioni. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune. 2. Studimi i fizibilitetit përmban, në mënyrë të veçantë: a) përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit; b) analizat teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore; c) studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë; ç) anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet. 3. Në studimin e fizibilitetit merren parasysh në veçanti interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës së parasë, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike dhe tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë. 4. Shfuqizuar; 5. Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat apo analiza e përmbledhur e dhënies me koncesion përmban: a) përcaktimin e llojit dhe objektin e koncesionit/partneritetit publik privat; b) vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore dhe vendore; c) vlerën e parashikuar të kontratës; ç) vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat; d) kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit."* Nga ana tjetër në VKM-në 575/2013 është shpjeguar në mënyrë të detajuar përmbajtja e analizës teknike, financiare, ekonomike si dhe studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë, por në asnjë dispozitë të ligjit 125/2013 apo VKM-së Nr. 575/2013 nuk është përcaktuar si komponent i nevojshëm edhe analiza ligjore dhe se çfarë duhet të përmbajë ajo. Një analizë e tillë, do krijonte qartësi dhe siguri si për autoritetin kontraktor edhe në mënyrë të veçantë për operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në garë.

Dokumentacioni udhëzues i organizatave ndërkombëtare të konsideruara si udhërrëfyfës të praktikave më të mira për organizimin e projekteve koncesionare/PPP, si *Udhëzimi Referues i Bankës Botërore për PPP (PPP Reference Guide - Version 3 2017)*; *Parimet e OSBE mbi Administrimin Publik të PPP (OECD Principles for Public Governance of Public-Private Partnerships - 2012)*; dhe *Udhëzuesi i Qendrës Europiane të Ekspertizës për PPP (The European PPP Expertise Centre (EPEC))*, i japin një rëndësi të veçantë kësaj faze që konsiderohet si faza e përgatitjes dhe strukturimit të koncesionit/PPP, pasi gjatë kësaj faze vlerësohet dhe peshohet mundësia dhe leverdisshmëria e një projekti koncesionar/PPP si dhe strukturohet në mënyrën më të plotë e të qartë të mundshme përpara se të njoftohet thirrja për oferta e propozime nga operatorët ekonomikë.

Siç përcakton Udhëzimi Referues i Bankës Botërore për PPP (PPP Reference Guide - Version 3 2017): *"Projektet eventuale PPP duhet ti nënshtrohen një procesi vlerësimi për tu siguruar që zhvillimi dhe zbatimi i tyre ka kuptim. Për çdo projekt PPP të propozuar, pesë janë kriteret që qeveritë duhet konsiderojnë kur vendosin nëse do ta zhvillojnë ose jo një projekt si PPP: Realizueshmëria (fizibiliteti) dhe qëndrueshmëria ekonomike e projektit; Çështjet mjedisore dhe sociale; Qëndrueshmëria tregtare; Vlera për para e PPP; Përgjegjësia fiskale".* Në vijim, ky Udhëzim i BB për PPP detajon në mënyrë analitike çfarë duhet të adresojë studimi i fizibilitetit në raport me secilin nga kriteret e sipërpërmendura.

Një vend i vecantë në hartimin e studimit të fizibilitetit duhet ti jepet Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe vlerësimi të ndikimeve sociale dhe çështjeve të punësimit. Kjo kërkesë parashikohet edhe nga Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 "Për dhënien e kontratave të koncesioneve" e cila në nenin 30 (3) të saj parashikon sa vijon *"Shtetet Anëtare sigurohen të marrin masat e duhura gjatë procedurës së koncesionit në përputhje me detyrimet e zbatueshme në fushën e ligjit mjedisor, social dhe të punës themeluar me ligjet e Bashkimit, ligjin kombëtar, marrëveshjet kolektive ose ndërkombëtare mjedisore, sociale, ligjin dhe dispozitat e punës të listuara në Aneksin X."*

Rekomandim: Neni 19 i Ligjit 125/2013, në paragrafin (3) të tij adreson deri diku në mënyrë të përgjithshme kriteret që duhet të mbajë në konsideratë studimi i fizibilitetit sipas Udhëzuesve për praktikën më të mira të organizatave ndërkombëtare, por nuk arrin të jetë ezaurues në këtë drejtim. Nga ana tjetër, paragrafët (2) dhe (5) të këtij neni krijojnë mbivendosje me njeri-tjetrin dhe është e nevojshme të harmonizohen, duke krijuar një disponim të veçantë gjithëpërfshirës mbi përmbajtjen e studimit të fizibilitetit. Gjithashtu është e nevojshme të specifikohet në këtë nen që përgatitja e studimit të fizibilitetit është një hallkë e detyrueshme për tu përmbushur nga autoriteti kontraktor përpara se të bëhet njoftimi i koncesionit.

Gjetje 5:

Në Ligjin 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk ka asnjë rregullim specifik në lidhje me detyrimin e autoritetit kontraktor që të sigurojë lejet, licensat, autorizimet dhe miratimet paraprake të lidhura me objektin e koncesionit dhe të nevojshme para se të procedohet me njoftimin e koncesionit. E vetmja procedurë miratimi paraprak e rregulluar në ligj është ajo e nenit 42 (1) mbi miratimin paraprak nga Ministria e Financave për projektet që kanë nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, në lidhje me përbalueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente. Realiteti ligjor dhe rregullator shqiptar, nga ana tjetër parashikon që në shumë fusha ku mund të jepen kontratat koncesionare/PPP, që mund të jenë sektorë të rregulluar ose jo, është e nevojshme që të merren leje, autorizime dhe miratime paraprake. Një ilustrim shumë i mirë është rasti i koncesioneve në hidroenergjetikë, ku parashikohet përveç deklaratave mjedisore që, si rregull janë dokumenti miratues i çdo raporti të Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis (VNM) i cili duhet të

jetë paraprakisht pjesë e studimit të fizibilitetit, edhe nevoja për të marrë autorizimet e nevojshme paraprake për përdorimin e burimeve ujore.

Në këtë drejtim, ky qëndrim është mbajtur edhe në dokumentat e praktikave më të mira ndërkombëtare si p.sh., Udhëzimi legjislativ mbi Projektet e Financuara Privatist i United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) (Legislative Guide on Privately Funded Infrastructure Projects - 2000), i cili përcakton që: *“Është e këshillueshme që të krijohen mekanizma institucionalë për të koordinuar aktivitetet e autoriteve publike përgjegjëse për lëshimin e lejeve, licensave, miratimeve apo autorizimeve të nevojshme për zbatimin e projekteve të infrastrukturës, të financuara privatist në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të zhvillimit dhe operimit të faciliteteve infrastukurore sipas llojit përkatës.”*

Rekomandim: Është e nevojshme që të ketë një përcaktim detyrues nëpërmjet një dispozite të veçantë ligjore që, para ndërmarrjes së hapit për fillimin e procedurës koncesionare nga Autoriteti Kontraktues, ky i fundit të ketë marrë të gjitha Autorizimet, Lejet dhe miratimet paraprake të organeve të tjera publike që kanë rol në këtë proces.

Gjetje 6:

Neni 25 i Ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe disa dispozita të veçanta në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, përcaktojnë mundësinë që operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkuara të jenë një nga mënyrat e nisjes së një procedure koncesioni. Për më tepër, VKM nr. 576, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet”, është një akt nënligjor që i dedikohet posaçërisht propozimeve të pakërkuara për hidrocentralet. Praktika ka treguar, se në shumë raste, propozimet e pakërkuara nuk kontribuojnë pozitivisht në një studim të thelluar paraprak të nevojës, mundësisë dhe fizibilitetit për koncesionet/PPP dhe gjithashtu nuk realizojnë një hapje të mjaftueshme të projektit të propozuar drejt një niveli maksimal konkurrence.

Së fundmi Gjykata e Europiane e Audituesve, në një raport të Marsit 2018¹⁶, ka rekomanduar ndër të tjera që PPP të mos promovohen dhe të mos zgjerohet më tej përdorimi i tyre deri sa të adresohen në nivel ligjor, insticional dhe strategjik çështje si: studimet dhe analizat e thelluara paraprake për ndërmarrjen e një procedure PPP, ndarja dhe adresimi i përshtatshëm i rreziqeve, zgjerimi i gamës së konkurrencës ndërmjet operatorëve etj.

¹⁶ Special Report No.9 of 2018 " Public Private Partnerships in the EU: Widespread shortcomings and limited benefits"

Monitorimi i fundit Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë konkludoi në lidhje me PPP se: **“Investimet publike dhe partneritetet publike private (PPP). Me rritjen e nivelit të investimeve publike, autoritet do të duhet t’u japin zgjidhje mangësive në menaxhimin e projekteve, përfshirë edhe në njësitë e qeverisjes vendore dhe në ndërmarrjet shtetërore (NSH). Nevojitet vendosja e prioriteteve mes projekteve, përfshirë PPP-të, brenda tavanit të investimeve publike, që do të duhej të financoheshin si duhet në kuadrin buxhetor afatmesëm. Sa u takon PPP-ve, një prioritet kyç është pakësimi i vendimmarrjeve të fragmentuara dhe fuqizimi i proceseve të vlerësimit të riskut brenda Ministrisë së Financave. Këto procese janë me rëndësi kritike, po të kemi parasysh detyrimet e mëdha të kushtëzuara që shpesh janë pjesë e kontratave të PPP-ve me një horizont kohor afatgjatë. **Praktika aktuale e propozimeve të pakërkuara duhet të eliminohet.** Plani i qeverisë për krijimin e një banke zhvillimi për të financuar investimet publike është mirë të marrë parasysh përvojën ndërkombëtare sa u takon risqeve që shoqërojnë subjekte të tilla, përfshirë risqet fiskale, financiare dhe të drejtimit të brendshëm.”**

Rekomandim: Duke pasur parasysh që aktualisht Shqipëria jo vetëm nuk ka një Strategji të veçantë për koncesionet/PPP dhe prokurimet publike, por as nuk ka përfunduar kuadrin e plotë të të gjitha Strategjive, Planeve dhe Programeve afatmesme dhe afatgjata të qeverisjes, do të ishte me vend që të kufizohen deri në eliminim praktika e koncesioneve/PPP nëpërmjet propozimeve të pakërkuara, duke u hequr fare si parashikim ligjor.

Gjetje 7:

Ligji 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, në nenin 4 të tij përcakton se: *“1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. 2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. 3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/ pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente. 4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.”*

Kjo dispozitë e ligjit, por edhe të tjera dispozita që rregullojnë: përkufizimet (neni 6), palët e përfshira dhe rolin e tyre (nenet 14, 15, 16, 17) si dhe konsideratat gjatë vendimmarrjes (neni 20) nuk përfshijnë të gjitha kërkesat e Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13.12.2011 “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private”, amenduar me Direktivën 2014/52/EU e

Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.04.2014 (VNM). Gjithashtu, në ligj mungon një dispozitë që të përcaktojë se çfarë duhet të përmbajë minimalisht raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, hartimi i planeve strategjike mjedisore është parakusht thelbësor për të pasur një proces efektiv të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Qeveria ka detyrim primar vënien në zbatim të parimeve të përgjithshme, ndaj duhet të ekzistojë edhe ligjërisht detyrimi që VNM-ja të jetë në përputhje me planet dhe programet strategjike të mjedisit.

Rekomandim: Konstatohet se është e nevojshme që ligji të saktësojë ndër të tjera: detyrimin e autoriteteve publike (kontraktore) që kur janë në rolin e nismëtarit të projektit, të kenë detyrime si zhvillues, pra të jenë këto autoritete që aplikojnë për miratim të raportit të VNM-së; faktorët mbi bazë të të cilëve do të identifikohen, përshkruhen dhe vlerësohen efektet e një projekti; çfarë duhet të përmbajë minimalisht raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis; dhe detyrimin që gjatë vendimmarrjes dhe konsultimit me autoritetet e tjera të përfshira të mbahen në konsideratë, planet, programet dhe strategjitë kombëtare që janë të lidhura me faktorët që vlerësohen, duke u harmonizuar edhe me nenin 25 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Gjetje 8:

Ligji 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” dhe Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe aktet respektive nënligjore, nuk trajtojnë në mënyrë të përshtatshme domosdoshmërinë e një planifikimi parakrak për elementet e efektit kumulativ. Pra, në rast të disa të dhënave të caktura për efektin që sjell p.sh. një ndërtim i ri hidrocentrali në një lumë, a ka parametra të paracaktuar se deri në cilin kufi këto efekte kumulative janë të lejueshme në mënyrë që të përcaktohet nëse mund të jepet leja mjedisore nëse është brenda këtyre parametrave? Efekti kumulativ është i aplikueshëm vetëm nëse ka një planifikim paraprak të hidrocentraleve si instrument strategjik i menaxhimit të zonës lumore të mbulimit. Në rastin tonë nuk ka një planifikim paraprak. Ky është edhe një argument më tepër përse është e nevojshme fillimisht të miratohet plani strategjik kombëtar dhe në vijim planet e veçanta të menaxhimit të baseneve.

Lloji më i përmendur i ndikimit kumulativ janë efektet e kombinuara të digave të shumta në shkarkimin e lumit dhe cilësinë e ujit. Cada dhe Hunsaker (1990) hetojnë efektet kumulative të zhvillimit të hidrocentraleve dhe impakteve në katër rrugë potenciale duke filluar nga efektet e thjeshta, efektet shtesë të një projekti të vetëm në efektet sinergjike që dalin nga projektet e shumëfishta. Më tej, bimët e njëpasnjëshme mund të rezultojnë në: • ndryshimin e modelit të sedimentit, • ndryshimin në kushtet e habitateve, • funksionimin e barrierës për migrimin e peshqve dhe • eutrofikimin.

Digat të ndërtuara në të njëjtin ujëmbledhës, ose në seri (d.m.th. përgjatë të njëjtit lumë) ose paralelisht (d.m.th. në degë të ndryshme), do të rezultojnë në mënyrë të pashmangshme në impaktet kumulative. Një ndikim kumulativ përcaktohet si efekti rritës i ndikimit të shtuar në ndikime të tjera. Një ndikim individualisht i parëndësishëm, kur kombinohet me të tjerët, mund të prodhojë një ndryshim të madh brenda një ekosistemi lumor. Efekti i përgjithshëm në një ekosistem lumor të ndikimeve kumulative mund të jetë më i madh se shumica e çdo ndikimi individual. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ato ndikime të rendit të dytë dhe të tretë që varen nga një numër ndikimesh në rend të poshtëm.

Efektet specifike varen kryesisht nga lloji dhe ndjeshmëria e sistemit të lumenjve, si dhe madhësia dhe distanca ndërmjet secilit prej hidrocentraleve/ digave. Në disa shtete, rëndësia e ndikimeve kumulative gjithnjë e më shumë njihet. Disa prej tyre, veçanërisht Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja kanë bërë përpjekje për të studiuar dhe përcaktuar ndikimet kumulative për përfshirjen e vlerësimit të ndikimeve të tyre në udhëzimet ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Konsiderimi i ndikimeve kumulative u bë një kërkesë formale në Aktin Kombëtar të Politikave Mjedisore në Shtetet e Bashkuara në fund të viteve 1970 dhe në Kanada në 1992.

Rekomandim: Është e nevojshme që duke ndërhyrë në Ligjin 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe/ose Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” dhe/ose Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe aktet respektive nënligjore, të përcaktohet si domosdoshmëri trajtimi i informacionit për efektet kumulative të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/ pranë zonës së projektit ndaj biodiversitetit.

Gjetje 9:

Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” dhe Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, nuk kanë asnjë parashikim specifik, që të lejojë drejtpërdrejtë publikun dhe/ ose organizatat e shoqërisë civile me fokus mbrojtjen e mjedisit që të kërkojnë në rrugë administrative rishikimin, ndryshimin ose revokimin e lejes mjedisore, kur konstatojnë shkelje të kësaj leje dhe kushteve përkatëse nga mbajtësi i saj.

Rekomandim: Do të ishte me vend rishikimi dhe ndryshimi i nenit 27 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, duke i dhënë të drejtën OJF-ve mjedisore dhe publikut të prekur drejtpërsëdrejti nga efektet negative, që të kërkojnë administrativisht rishikimin, ndryshimin dhe/ose revokimin e lejes së mjedisit, kur konstatojnë që mbajtësi i saj nuk shmang, zvogëlon dhe menaxhon çdo efekt negativ që prek specie të mbrojtura ose të rrezikuara dhe nuk respekton kushtet e miratuara me lejen e mjedisit.

Gjetje 10:

Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", në nenin 7 të tij përcakton se: "Llojet e kërcënuara dhe endemike, të përcaktuara në listën e kuqe, gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore, që ka të bëjë me: a) hartimin dhe zbatimin e planeve të veçanta të veprimit, për ruajtjen e këtyre llojeve, sidomos kur shumimi i tyre, në kushte natyrore, është shumë i kufizuar; b) monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes faktike e të ecurisë së popullatave të tyre; c) **shndërrimin e habitateve të tyre në zona të mbrojtura, që favorizojnë mbrojtjen dhe shumimin e tyre;** ç) nxitjen e përkrahjen e nismave dhe të veprimtarive, që synojnë shtimin e popullatave të llojeve, nëpërmjet shumimit në gjendje robërie dhe lëshimin e tyre në mjediset natyrore; d) ndalimin dhe kufizimin e veprimtarive, që çojnë në shkatërrimin e llojeve të kërcënuara e endemike të faunës së egër, në zvogëlimin e numrit të popullatave të tyre, në dëmtimin e habitateve të tyre, të rrugëve të shtegtitimit e të kushteve të shumimit; dh) hartimin dhe publikimin e librit të kuq të llojeve të mbrojtura; e) sensibilizimin e publikut për mbrojtjen e tyre."

Rekomandim: Është me vend të kërkohet që të përcaktohet me anë të një VKM-je një moratorium disa vjeçar për mos dhënie konçesionesh në ato mjedise ku është e nevojshme të realizohet një studim për të evidentuar ekzistencën e llojeve të kërcënuara dhe endemike. P.sh.: në Vjosë ka rezultuar se ekzistojnë 40 lloje të raportuara për herë të parë në Shqipëri. Si rrjedhojë, dhënia e hidrocentraleve në Vjosë e çon shtetin shqiptar në shkelje të nenit 7 të Ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër".

Gjetje 11:

Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në nenin 9 të tij parashikon që: "ç) çdo autoritet kontraktor, përpara se të nisë një procedurë koncesioni për përdorimin e burimeve ujore, duhet të marrë miratimin, në parim, nga Këshilli Kombëtar i Ujit."

Rekomandim: Para se të japë miratimin për dhënie koncesioni, ky Këshill duhet të marrë një mendim paraprak nga Këshilli i Basenit Ujor duke qenë se janë pikërisht këto Këshilla të Baseneve që kanë në kompetencë vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, analizën ekonomike të përdorimit të ujërave.

Gjetje 12:

Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në nenin 39 të tij parashikon që: "... 2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë. 3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup ujor natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni ujor. 4. Pavarësisht nga

sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355)."

Rekomandim: Përveç rrjedhjes minimale duhet shtuar edhe krijimi i bypass-it për faunën dhe sedimentet si dhe të merren masa që të zvogëlohen ndryshimet drastike të niveleve të larta dhe të ulëta të ujit në rezervuarët e magazinimit të ujit, si dhe të shtohet një përcaktim i veçantë për krijimin e strukturës që mundëson kalimin e faunës.

Gjetje 13:

Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në nenin 51 të tij parashikon që: *"Autorizimi, leja ose koncesioni lëshohet vetëm në qoftë se: a) aktiviteti i personit fizik apo juridik, që është titullar i autorizimit, lejes apo koncesionit, nuk ndikon negativisht në përdorimin e ujërave; b) është në përputhje me planin e menaxhimit të basenit ujqor përkatës; c) nuk çon në shkeljen e normave të cilësisë së ujit, të përcaktuara në këtë ligj; ç) nuk çon në cenimin e objektivave mjedisore përkatës, të përcaktuar në këtë ligj; d) nuk bie ndesh me programin e masave, të parashikuar në bazë të këtij ligji."*

Rekomandim: Është me vend që të shtohet një përcaktim i veçantë ku të kushtëzohet që aktiviteti nuk shkakton dëme për burimin ujqor në të cilin operojnë aktivitete të tjera që përfshijnë të njëjtin burim ujqor, i cili shërben edhe për qëllime të tjera të rëndësishme publike (këtu nënkuptohet vaditje për tokat përreth etj.)

Gjetje 14:

Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në nenin 54 të tij parashikon që: *"1. Autorizimi, leja dhe koncesioni mund të pezullohen ose të ndryshohen kur titullari përkatës nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. 2. Pezullimi dhe ndryshimi i kushteve që përmbahen në licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet kryhen nga organi lëshues: a) si pasojë e një urdhri për thatësisirën, të lëshuar në bazë të këtij ligji; b) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore; c) me kërkesë të mbajtësit të titullit; ç) në rast të mosrespektimit nga titullari të kushteve të autorizimit, lejes ose koncesionit."*

Rekomandim: Duke harmonizuar edhe kërkesat e Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", dhe Ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", mund të shtohet edhe një rast tjetër për pezullimin ose ndryshimin që ka të bëjë me nevojën për mbrojtjen e biodiversitetit.